

M. Ziu  
Pet on kim



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
PROKURORIA E POSAÇME  
KUNDËR KORRUPSIONIT DHE KRIMIT TË ORGANIZUAR  
TIRANË**

Nr. 475 / Prot. / (E.M.)

Tiranë, më 08.06.2021

**Lënda:** Dergohet vendim mosfillimi


**DREJTUAR:** **PARTIA DEMOKRATIKE E SHQIPËRISË  
TIRANË**

Bashkalidhur ju dergojme vendim per mosfillimin e procedimit penal ne kuader te kallzimit penal nr. 188 i vitit 2021.

Duke ju falenderuar per mirekuptimin!

**DREJTUESI I PROKURORISE**

**ARBEN KRAJA**





**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**PROKURORIA E POSAÇME**  
**KUNDËR KORRUPSIONIT DHE KRIMIT TË ORGANIZUAR**  
**TIRANË**

---

**V E N D I M**  
**PËR MOSFILLIMIN E ÇËSHTJES**

Në Tiranë, më datë 03.06.2021, unë **Enkeleda MILLONAI**, prokurore në Prokurorinë e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar Tiranë, pasi studjova materialin kallëzues nr. 188 të vitit 2021,

**K O N S T A T O V A**

1. Me kallzimin penal të paraqitur në Prokurorinë e Posaçme Kunder Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar Tirane, Partia Demokratike e Shqipërisë kallzon [REDAKTUAR] me detyrë [REDAKTUAR] shtetasin [REDAKTUAR] me detyrë [REDAKTUAR] shtetasin [REDAKTUAR] me detyrë [REDAKTUAR] dhe në vijim një sërë kryetarë bashkish e konkretisht të Bashkisë Tiranë, Kamëz, Kurbini, Shijak, Vorë, Durrës, Kavajë, Mirditë, Rrogozhinë, Krujë dhe Lezhë.

Sipas kallzuesit, më datë 25.05.2021 u zhvilluan zgjedhjet parlamentare dhe të paktën nga muaji janar 2021 është vënë re shtim në masë i veprimeve të kundërligjshme të qeverisë, në funksion të ndikimit tek vullneti i qytetarëve dhe për pasojë, ndryshimit me çdo mjet dhe mënyrë të paligjshme, të rezultatit të zgjedhjeve.

Pas tërmetit të datës 26.11.2019, Qeveria Shqiptare miratoi një sërë ligjesh, vendime të Këshillit të ministrave dhe vendime të Këshillave Bashkiakë, të cilat lidhen me hartimin dhe zbatimin e masave, për eliminimin e pasojave dhe rindërtimin e objekteve të dëmtuara e të shkatërruara nga fatkeqësia natyrore e tërmetit, duke përcaktuar objektet që përfitojnë dhe masën e përfitimit.

Duke shfrytëzuar fatkeqësinë natyrore, sipas kallzuesit, Qeveria dhe Bashkitë, kanë krijuar një skemë kriminale të blerjes së votës dhe korrupsionit, me fondet e rindërtimit nga tërmeti, në funksion të maksimizimit të paligjshëm të votave për Partinë Socialiste, duke konsumuar vepra të rënda penale dhe afera të jashtëzakonshme korruptive. Kjo skemë kriminale e blerjes së votës, nëpërmjet granteve të rindërtimit për individë, faktohet nga të dhënat zyrtare të Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit, Ministria e Financave (<https://www.financa.gov.al/thesari-borxhi>) për periudhën e fushatës zgjedhore, lidhur me fondin e rindërtimit dhe konkretisht, shtesat buxhetore në transfertat e pakushtëzuara në 11 Bashki. Bazuar në të dhënat publike të Ministrisë së Financave, me vendime të Këshillit të Ministrave janë përdorur për fushatë, në funksion të maksimizimit të votave të Partisë Socialiste, transfertat e pakushtëzuara të fondit të rindërtimit, për periudhën zgjedhore 01.01.2021 deri 25.05.2021, periudhë katër mujore para ditës së

zgjedhjeve, parashikuar nga Kodi Zgjedhor dhe vendimi nr. 9/2020 të Komisionit Rregullator, Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Shtesa buxhetore, Tranfertë e pakushtëzuar për 11 bashki, nga Fondi i rindërtimit për periudhën 01.01.2021 – 25.04.2021 është 15 430 836 420 lekë. Vetëm në 30 ditët e fundit të fushatës zgjedhore, kjo transfertë e pakushtëzuar drejt bashkive të prekura nga tërmeti, ka arritur vlerën prej 8 574 636 50 lekë. Në kundërshtim me Kodin Zgjedhor, katër muajt e parë të vitit, qeveria ka shpenzuar nga Fondi i rindërtimit duke transferuar tek bashkitë, si transfertë të pakushtëzuar 56 % të totalit të Fondit të Rindërtimit. Shumica e tranfertave, kanë qenë transferta tek individ, pra dëmshpërblim me para në dorë. Më datë 01.12.2020 në një raport të Fondit Monetar (FMN), qeveria shqiptare u kritikua për shkak të mosrealizimit të projektit për rindërtimin pas tërmetit, që në shtator ishte vetëm 8 % e totalit. Papritur, në vitin 2021, ka një përqëndrim për realizimin e Fondit të Rindërtimit, sidomos për periudhën zgjedhore 25.03.2021 – 25.04.2021. Në periudhën zgjedhore sipas Kodit Zgjedhor, e konkretisht më datë 25.03.2021, në mbledhjen e Këshillit të Ministrave u alokua për bashkitë si transfertë të pakushtëzuar nga fondi i rindërtimit, vlera 7 488 614 019 lekë, më datë 31.03.2021, vlera 391 879 325 lekë, më datë 14.04.2021, vlera 694 301 163 lekë. Me vendim të Këshillit të Ministrave, për periudhën janar deri 24 prill, periudhë zgjedhore sipas Kodit Zgjedhor, Qeveria shqiptare ka alokuar për bashkitë si transfertë të pakushtëzuar nga Fondi i rindërtimit vlerën 6 856 1199 913 lekë, për periudhën 25 mars deri më 25 prill, vlerën prej 8 574 646 507 lekë dhe për periudhën janar deri 25 prill, vlerën 15 430 836 420 lekë.

Sipas kallzuesit, të gjitha transfertat e pakushtëzuara nga fondi i rindërtimit të kryera gjatë periudhës zgjedhore, janë përdorur me qëllim deformimin e votës së qytetarëve në favor të maksimizimit të paligjshëm të votave për Partinë Socialiste.

Në ligjin për buxhetin e shtetit për vitin 2021, transfertat e pakushtëzuara për 11 bashki ishin në total 8 299 271 256 lekë, por nëpërmjet VKM-ve të sipërcituara, në katër muaj, shtesa e tranfertave të pakushtëzuara, ka qenë në vlerën 15 430 836 420 lekë. Në vlerë, rritjen më të lartë e kanë Bashkitë Tiranë, Durrës, Kamëz dhe Kurbin ndërsa si peshë kundrejt tranfertave të pakushtëzuara nga ligji për buxhetin e vitit 2021, rekord mbajnë Bashkia e Vorës me 549 %, Bashkia e Kurbinit me 340 %, Bashkia e Tiranës me 250 % dhe Bashkia Shijak me 228 %. Nëse krahasohen vlerat në Dhjetor 2020 me shtesat e marra sipas bashkive, transferta të pakushtëzuara Rindërtimi VKM parazgjedhore dhe VKM gjatë periudhës zgjedhore, shohim një rritje të konsiderueshme në periudhën që Kodi Zgjedhor i njuh si data zgjedhore.

Sipas kallzuesit, në këto zgjedhje nuk ka pasur një vijë ndarëse midis shtetit dhe partisë në pushtet, kjo pasi administrata dhe asetet publike, janë vënë në mënyrë të paligjshme në dispozicion të Partisë Socialiste. Sipas kallzuesit, Ministri i Shtetit për Rindërtimin dhe Kryetarët e Bashkive, me veprime aktive kriminale dhe me dashje të drejtëpërdrejtë, kanë organizuar dhe zbatuar një skemë kriminale të blerjes së votës, nëpërmjet fondeve të rindërtimit, veçanërisht në qarkun e Tiranës dhe Durrësit, pasi këto dy qarqe nxjerrin numrin më të madh të deputetëve. Sipas kallzuesit kjo skemë kriminale e blerjes së votës është shoqëruar me afera të jashtëzakonshme korruptive.

Konkretisht pretendohet se janë konsumuar veprat penale të shpërdorimit të detyrës, korrupsionit aktiv në zgjedhje, përdorimi i funksionit publik për veprimtari politike ose zgjedhore, korrupsioni pasiv në zgjedhje, parashikuar nga nenet 248, 328, 328/a, 328/b të K.Penal.

#### ***Verifikimi i kryer:***

Nga aktet rezulton se me VKM nr. 750 datë 27.11.2019 i ndryshuar, është vendosur shpallja e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në qarqet Durrës, Tiranë, Lezhë, si pasojë e dëmeve të shkaktuara nga tërmeti i datës 26.11.2019, deri më datë 31.03.2020. Gjithashtu është vendosur Krijimi i Komitetit Ndërmintor të Emergjencave Civile (KNEC), si organi më i lartë për koordinimin dhe bashkërendimin e veprimeve të institucioneve shtetërore dhe të subjekteve private, si dhe të burimeve financiare e materiale për përballimin e fatkeqësisë natyrore.

Me aktin normativ nr. 9 datë 16.12.2019 “*Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrorer*” siç përshkruhet në objektin e tij, neni 1, është përcaktuar rregullimi i funksionimit të organeve përgjegjëse për rehabilitimin dhe rindërtimin e komuniteteve dhe të territoreve të prekura nga fatkeqësitë natyrore ose fatkeqësi të tjera si dhe zhvillimi i territoreve të reja, duke përcaktuar detyrat dhe përgjegjësitë e tyre, programet e procesit të rindërtimit, funksionimin e fondit të rindërtimit dhe procedurat përkatëse. Ky akt normativ është miratuar me ligjin nr. 97/2019, i shpallur me dekretin e Presidentit të Republikës së Shqipërisë nr. 11398 datë 27.12.2019.

Me ligjin nr. 137/2020 “*Për buxhetin e vitit 2021*” i ndryshuar, është përcaktuar buxheti për 2021. Transferta e pakushtëzuar (TP) përcaktohet se rregullohet nga ligji nr. 68 datë 27.04.2017 “*Për financat e Vetëqeverisjes Vendore*” i cili përcakton madhësinë dhe mënyrën e ndarjes për Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore.

Me VKM nr. 11 datë 10.01.2020 është vendosur Miratimi i fushës së përgjegjësisë shtetërore të ministrit të Shtetit për Rindërtimin, si dhe të kompetencave për realizimin e tyre, sipas këtij vendimi. Ministri i Shtetit për Rindërtimin është përgjegjës për hartimin dhe ndjekjen e zbatimit të masave për eliminimin e pasojave dhe rindërtimin e objekteve të dëmtuara e të shkatërruara nga fatkeqësia natyrore, tërmeti i datës 26.11.2019. Ndërmjet të tjerave, ka si përgjegjësi të përgatisë dhe paraqesë për miratim në Këshillin e Ministrave, projektakte ligjore e nënligjore.

Me VKM nr. 189 datë 25.03.2021, është vendosur përdorimi i fondit të rindërtimit në masën 998 675 000 lekë, për financimin e rikonstruksionit të njësive individuale të banimit dhe njësive të banimit në ndërtesa (pallat) për ata individë, të cilët përfitojnë nga grantet e rikonstruksionit, banesat e të cilëve janë klasifikuar si objekte të dëmtuara rëndë apo të dëmtuara lehtë si pasojë e fatkeqësisë natyrore dhe që nuk duhen rindërtuar nga e para, por kanë nevojë për punime rikonstruksioni ose riparime, në bashkitë Tiranë, Durrës dhe Vorë. Efekti financiar, sipas pikës 1, të këtij vendimi, të përballohet nga pjesa e financuar nga shpenzimet e fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2021, dhe t’u transferohet bashkive Tiranë, Durrës dhe Vorë në formën e transfertës së pakushtëzuar.

Me VKM nr. 200 datë 25.03.2021, është vendosur përdorimi i fondit të rindërtimit për financimin e rikonstruksionit të objekteve arsimore në bashkitë Mirditë dhe Kamzë, në masën 466 930 089 lekë pa TVSH.

Me VKM nr. 201 datë 25.03.2021, është vendosur përdorimi i fondit të rindërtimit, në masën 1 058 293 376 lekë pa TVSH, për financimin e rforcimit të njësive të banimit në ndërtesa (pallat), të cilat janë klasifikuar si objekte të pabanueshme ose të dëmtuara rëndë apo të dëmtuara lehtë dhe që nuk duhen rindërtuar nga e para, por kanë nevojë për punime rikonstruksioni ose riparime, nga bashkitë Durrës dhe Kamzë. Përdorimin e fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2021, në masën 211 658 675 lekë pa TVSH, për financimin e rforcimit të njësive të banimit në ndërtesa (pallat), të cilat janë klasifikuar si objekte të pabanueshme ose të dëmtuara rëndë apo të dëmtuara lehtë dhe që nuk duhen rindërtuar nga e para, por kanë nevojë për punime rikonstruksioni ose riparime, nga bashkitë Durrës dhe Kamzë.

Me VKM nr. 202 datë 25.03.2021, *“Për një shtesë në VKM nr. 645 datë 03.08.2020 ‘Për përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e rindërtimit të njësive të banimit në ndërtesa (pallat) dhe ndërtesave publike, në zonat e reja për zhvillim, në Njësitë administrative 4 dhe 8, zona “5 Maji” dhe Njësinë Administrative 6, Zona Kombinat, Bashkia Tiranë, të ndryshuar është vendosur: Përdorimi i fondit për vitin 2021 të jetë në masën 1 990 233 627 lekë dhe i transferohet Bashkisë Tiranë për financimin e rindërtimit të njësive të banimit në ndërtesa (pallat) dhe ndërtesave publike, në zonat e reja për zhvillim, në njësitë administrative 4 e 8, zona “5 Maji”, dhe Njësinë Administrative 6, zona “Kombinat”, Bashkia Tiranë, në formën e transfertës së pakushtëzuar.*

Me VKM nr. 204 datë 25.03.2021 *“Për një shtesë në VKM nr. 212 datë 11.03.2020 “Për përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e rindërtimit të objekteve arsimore” të ndryshuar, është vendosur: Përdorimi i fondit, për vitin 2021, do të jetë në masën 3 928 793 173 lekë, nga i cili Bashkisë Tiranë, për vitin 2021, i transferohet fondi prej 3 928 793 173 lekë, në formën e transfertës së pakushtëzuar, për financimin e rindërtimit dhe mobilimit të objekteve arsimore, në Bashkinë Tiranë.*

Me VKM nr. 205 datë 25.03.2021, është vendosur përdorimi i fondit të rindërtimit, në masën 222 267 242 lekë, për financimin e rindërtimit të banesave individuale për ata individë, të cilët përfitojnë nga grantet e rindërtimit, banesat e të cilëve janë klasifikuar si objekte që duhen rindërtuar nga e para, sipas aktekspertizave të thelluara, në bashkitë Durrës dhe Kavajë. Efekti financiar, sipas pikës 1 të këtij vendimi, përballohet nga shpenzimet e fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2021, dhe u transferohet bashkive Durrës dhe Kavajë në formën e transfertës së pakushtëzuar, për financimin e rindërtimit të banesave individuale për ata individë, të cilët përfitojnë nga grantet e rindërtimit, banesat e të cilëve janë klasifikuar si objekte që duhen rindërtuar nga e para.

Me VKM nr. 206 datë 25.03.2021 është vendosur përdorimi i fondit të rindërtimit, në vlerën 227 211 426 lekë pa TVSH, për financimin e rindërtimit të stacionit të zjarrfikëses dhe godinës së bordit të kullimit, Bashkia Kavajë. Bashkisë Kavajë, në buxhetin e miratuar për vitin 2021, i transferohet fondi në masën 45 442 285 lekë pa TVSH, në formën e transfertës së pakushtëzuar.

Me VKM nr. 211 datë 31.03.2021, është vendosur përdorimi i fondit të rindërtimit, në masën 14 820 655 lekë pa TVSH, për financimin e supervizimit e të kolaudimit të rindërtimit dhe rikonstruksionit të 9 (nëntë) objekteve arsimore, si dhe të rforcimit të njësive të banimit në

ndërtesa (pallat) të ndara me lote, në Bashkinë Kamzë. Efekti financiar, përballohet nga shpenzimet buxhetore të fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2021, dhe i transferohet Bashkisë Kamzë në formën e transfertës së pakushtëzuar.

Me VKM nr. 212 datë 31.03.2021, është vendosur përdorimi i fondit të rindërtimit, në masën 143 662 566 lekë, për financimin e rindërtimit të banesave individuale për ata individë, të cilët përfitojnë nga grantet e rindërtimit, banesat e të cilëve janë klasifikuar si objekte që duhen rindërtuar nga e para sipas aktekspertizave të thelluara, në Bashkinë Shijak. Efekti financiar, përballohet nga shpenzimet e fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2021, dhe i transferohet Bashkisë Shijak në formën e transfertës së pakushtëzuar.

Me VKM nr. 213 datë 31.03.2021 është vendosur bërja e disa ndryshimeve në VKM nr. 775 datë 30.09.2020 për përdorimin e fondit të rindërtimit nga bashkia Durrës, miratuar në buxhetin e vitit 2020 për financimin e hartimit të projekt preventivit dhe rificimin e hidrovorit të Durrësit.

Me VKM nr. 215 datë 31.03.2021 është vendosur përdorimi i fondit të rindërtimit, në masën 716 338 013 lekë pa TVSH, për financimin e rindërtimit të njësive individuale të banimit, të cilat janë klasifikuar si objekte që duhen ndërtuar nga e para, në bashkitë Lezhë dhe Kurbin. Përdorimin e fondit të rindërtimit për vitin 2021, në masën 143 267 602 lekë pa TVSH, për financimin e rindërtimit të njësive individuale të banimit. të cilat janë klasifikuar si objekte që duhen ndërtuar nga e para, në bashkitë Lezhë dhe Kurbin.

Me VKM nr. 233 datë 14.04.2021 është vendosur përdorimi i fondit të rindërtimit, në masën 360 194 728.38 lekë, për financimin e rikonstruksionit ose të riparimit të mjediseve në bashkëpronësi ose të përbashkëta në ndërtesa (pallat), në Bashkinë Kurbin. Fondi financiar, përballohet nga shpenzimet buxhetore të fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2021, dhe t'i transferohet Bashkisë Kurbin, në formën e transfertës së pakushtëzuar.

Me VKM nr. 234 datë 14.04.2021 është vendosur përdorimi i fondit të rindërtimit, në masën 43 634 850 lekësh, për financimin e prishjes së njësive individuale të banimit, në Bashkinë Kurbin. Fondi financiar, të përballohet nga shpenzimet e fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2021, dhe t'i transferohet Bashkisë Kurbin në formën e transfertës së pakushtëzuar.

Me VKM nr. 235 datë 14.04.2021 është vendosur përdorimi i fondit të rindërtimit, në masën 95 600 000 lekë, për financimin e rindërtimit të banesave individuale për ata individë, të cilët përfitojnë nga grantet e rindërtimit, banesat e të cilëve janë klasifikuar si objekte që duhen rindërtuar nga e para, në Bashkinë Kamzë. Efekti financiar, përballohet nga shpenzimet e fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2021, dhe i transferohet Bashkisë Kamzë në formën e transfertës së pakushtëzuar.

Me VKM nr. 236 datë 14.04.2021 është vendosur përdorimi i fondit të rindërtimit, në masën 707 302 333 lekë pa TVSH, për financimin e rindërtimit të godinës së kopshtit publik dhe të godinës së Bashkisë Vorë, Bashkia Vorë. Bashkisë Vorë, për vitin 2021, i transferohet fondi në masën 141 460 466 lekë pa TVSH, në formën e transfertës së pakushtëzuar.

Me VKM nr. 237 datë 14.04.2021 është vendosur përdorimi i fondit të rindërtimit, në masën 31 687 604 lekë, për financimin e hartimit të projektit të ndërhyrjeve rehabilituese/përshtatëse të nevojshme për kthimin e strukturës së njësive individuale të banimit dhe njësive të banimit në ndërtesa (pallat), të cilat janë klasifikuar me dëmtime të mëdha strukturore ose dëmtime shumë të rënda jostrukturore dhe që nuk duhen rindërtuar nga e para, por kanë nevojë për punime rikonstruksioni ose riparime. Efekti financiar, përballohet nga shpenzimet buxhetore të fondit të rindërtimit, miratuar në buxhetin e shtetit për vitin 2021, dhe i transferohet në formën e transfertës së pakushtëzuar Bashkisë Vorë.

### *Analiza ligjore:*

Kodi Zgjedhor dhe aktet nënligjore të miratuara në kuadrin e zbatimit të tij, përcaktojnë si të drejtat ashtu edhe detyrimet e subjekteve. Në këto akte, janë parashikuar edhe një tërësi shkeljesh që çënojnë procesin zgjedhor. Për një pjesë të shkeljeve, legjislatori ka vlerësuar se përbëjnë kundravajtje administrative dhe një pjesë tjetër kualifikohen si vepër penale. Kualifikimi si vepër penale, vjen në respektim të faktit të plotësisht të të gjitha kushteve që kërkon ekzistenca e veprës penale, ku ndërmjet të tjerave, evidentohen parashikimi në ligjin penal (kundërligjshmëria) dhe rrezikshmëria shoqërore.

Kodi Zgjedhor në nenin 91 “*Ndalimi i përdorimit të burimeve publike në mbështetje të subjekteve zgjedhore*” të tij parashikon:

1. Me përjashtim të rasteve të parashikuara me ligj, **nuk mund të përdoren ose të vihen në mbështetje të kandidatëve, të partive politike ose të koalicioneve në zgjedhje burime të organeve apo enteve publike në nivel qendror ose vendor, apo çdo lloj enti tjetër ku shteti zotëron kapitale apo kuota ose/dhe emëron shumicën e organit mbikëqyrës apo organit administrues të entit, pavarësisht nga burimi i kapitalit ose pronësia.**

2. Në kuptim të këtij neni, “*burime*” quhen asetet e luajshme dhe të paluajshme, të parashikuara në nenin 142 të Kodit Civil, si dhe çdo burim njerëzor i institucionit. ...

**...4. Katër muaj para datës së zgjedhjeve deri në formimin e qeverisë së re pas zgjedhjeve ndalohet propozimi, miratimi ose nxjerrja e akteve ligjore ose nënligjore, të cilat parashikojnë dhënien e përfitimeve për kategori të caktuara të popullsisë, të tilla si aktet që parashikojnë rritjen e pagave, pensione, mbështetjes ekonomike apo sociale, uljen ose heqjen e taksave, vendosjen e amnistive fiskale, privatizimin apo dhënien e pasurive a të shpërblimeve, etj., përveçse kur nisma kushtëzohet nga gjendje të fatkeqësisë natyrore. ....**

Me vendimin nr. 9 datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator, Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, janë miratuar rregullat e Raportimit të Veprimtarive me karakter publik të çdo institucioni publik me kapital shtetëror, agjensive, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara si dhe monitorimin e veprimtarive, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve. Në nenin 3 pika 3 është parashikuar se katër muaj para datës së zgjedhjeve...ndalohet propozimi, miratimi i akteve ligjore ose nënligjore, ose nxjerrja e tyre me qëllim informimin e publikut në lidhje me vendimmarrjen e institucionit miratues në faqen e tij zyrtare, të cilat parashikojnë dhënien e

përfitimeve për kategori të caktuara të popullsisë, ...përveçse kur nisma kushtëzohet nga gjendje të fatkeqësisë natyrore ose të epidemisë/pandemisë apo ka si qëllim zbatimin e një detyrimi ligjor me karakter ndërkombëtar apo zbatimin e një vendimi gjyqësor të formës së prerë.

Sipas nenit 9 të kësaj rregullorje, në rast se Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, kryesisht ose me kërkesë të të tretëve konstaton se veprimtaria publike përbën veprimtari të ndaluar sipas nenit 3 të këtij vendimi dhe/ose keqpërdorim të burimeve shtetërore, urdhëron ndalimin e zhvillimit të veprimtarisë publike përkatëse. Sipas nenit 10 në rast se subjektet nuk raportojnë, raportojnë pjesërisht ose zhvillojnë veprimtarinë, pavarësisht ndalimit të bërë nga KQZ, kur shkelja nuk përbën veprë penale dënohen me gjobë nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve. Gjithashtu sipas këtij neni, masa me gjobë parashikohen edhe nëse titullari i institucionit ka penguar raportimin, ka ndikuar apo urdhëruar që të bëhet me vonesë apo veprimtaria apo aktiviteti publik është zhvilluar pavarësisht ndalimit të bërë nga KQZ.

Me urdhërin nr. 46 datë 22.01.2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve është përditësuar lista e institucioneve qendrore dhe vendore të pavarura dhe të varësisë që janë të detyruara të raportojnë në KQZ të gjitha veprimtaritë me karakter publik që planifikojnë të zhvillojnë në periudhën katër mujore para datës së zgjedhjeve deri ditën e zgjedhjeve. Mes tyre, identifikohen bashkitë, Kryeministria si dhe Ministria e Shtetit për rindërtim.

Ashtu si më lart u konstatua, rezulton se në periudhën e ndaluar sipas parashikimeve të akteve që rregullojnë zgjedhjet, janë miratuar disa akte, që në fakt ofrojnë dhënie përfitimesh për kategori të caktuara të popullsisë. Që të vlerësojmë nëse kemi apo jo ezaurimin e ndonjë veprë penale, sjellim fillimisht në vëmendje parashikimet e nenit 248 të K.Penal, "*Shpërdorimi i detyrës*". Kjo dispozitë parashikon se *kryerja ose moskryerja me dashje e veprimeve a e mosveprimeve në kundërshtim me ligjin, që përbën mospërmbushje të rregullt të detyrës, nga personi që ushtron funksione publike, kur i kanë sjellë atij ose personave të tjerë përfitime materiale ose jomateriale të padrejta a kanë dëmtuar interesat e ligjshëm të shtetit, të shtetasve dhe të personave të tjerë juridikë, nëse nuk përbën veprë tjetër penale, dënohet me burgim deri në shtatë vjet*. Konstatohet se me nxjerrjen e VKM-ve përkatëse, nuk ndodhemi para ekzistencës së kësaj veprë penale, pasi në fakt sjellja e kryer, nuk përbën mospërmbushje të rregullt të detyrës, pasi janë akte të nxjerra brenda kompetencave e sipas ligjit, përfitimet materiale që i kanë ardhur të tretëve për shkak të përdorimit të fondit të rindërtimit nuk janë të padrejta. Për më tepër, pretendimi i kallzuesit është i qartë, se veprimet (sjellja e pretenduar kriminale) ka ndodhur për një arsye të caktuar, që ka të bëjë me fitimin e zgjedhjeve. Kodi Penal parashikon shprehimisht se nuk mund të arsyetohet mbi ekzistencën e veprës penale të shpërdorimit të detyrës kur sjellja mund të kualifikohet në një dispozitë tjetër të Kodit Penal.

Parashikimet e bëra nga Kodi Zgjedhor, mund të çojnë drejt inkudrimit të sjelljes së zyrtarëve, në rastin konkret në ndonjë nga veprat penale në fushën e zgjedhjeve. Nga kallzuesi është pretenduar se janë konsumuar veprat penale të korrupsionit aktiv në zgjedhje apo korrupsionit pasiv në zgjedhje, të parashikuara këto nga nenet 328 dhe 328/b të Kodit Penal.

Neni 328 "*Korrupsioni aktiv në zgjedhje*" i K.Penal, parashikon: *Ofrimi ose dhënia e të hollave, të mirave materiale, premtimi për vend pune ose favorizime të tjera në cilëndo formë në kundërshtim me ligjin, për zgjedhësin ose persona të tjerë të lidhur me të, me qëllim marrjen e*



*firmës për paraqitjen e një kandidati në zgjedhje, për të votuar në një mënyrë të caktuar, për të marrë pjesë ose jo në votime, ose për t'u angazhuar në veprimtari të paligjshme për mbështetjen e një kandidati ose partie politike, përbën veprë penale dhe dënohet me burgim nga një vit deri në pesë vjet.*

Neni 328/b “Korrupsioni pasiv në zgjedhje” i K.Penal, parashikon: *Kërkimi ose pranimi nga zgjedhësi i të hollave, të mirave materiale, ose favorizimeve të tjera në cilëndo formë në kundërshtim me ligjin, për vete ose të tjerët, me qëllim për të dhënë firmën për paraqitjen e një kandidati në zgjedhje, për të votuar në një mënyrë të caktuar, për të marrë pjesë ose jo në votime, ose për t'u angazhuar në veprimtari të paligjshme në mbështetjen e një kandidati ose partie politike, përbën veprë penale dhe dënohet me burgim nga një deri në pesë vjet.*

Nga aktet dhe të dhënat e paraqitura nuk evidentohet se është janë ofruar apo dhënë të mira materiale në kundërshtim me ligjin apo se janë kërkuar ose pranuar në kundërtim me ligjin (*me kuadrin ligjor për dhënien e tyre dhe jo ndalime që vijnë për efekt të periudhës zgjedhore*). Korrupsioni është një marrëveshje mes dy palëve dhe në rastin konkret, nuk mund të konkludohet se ekziston një marrëveshje mes pjesës së popullsisë që ka mbetur e dëmtuar nga tërmeti dhe qeverisë, për të përfituar ndonjë të mirë në kundërshtim me ligjin, me qëllim për të votuar në një mënyrë të caktuar. Nuk ekziston asnjë e dhënë apo indicie që të mbështesë këtë.

Ndërkohë, neni 328/a i K.Penal, “Përdorimi i funksionit publik për veprimtari politike ose zgjedhore” parashikon në paragrafin e katërt të tij se: *“Përdorimi nga një punonjës që kryen një detyrë shtetërore, i të mirave publike, funksionit ose veprimtarisë shtetërore, ose i burimeve financiare ose njerëzore, me qëllim favorizimin e një partie politike ose kandidati në zgjedhje, në kundërshtim me ligjin dhe qëllimin e detyrës, përbën veprë penale dhe dënohet me burgim nga një vit deri në tre vjet”.*

Sjellja e mësipërme, pra mund të trajtohet vetëm nën dritën e nenit 328/a të K.Penal. Megjithatë organi procedues sjell në vëmendje se në përputhje edhe me rregullat e parashikuara nga dispozitat ligjore dhe nënligjore që rregullojnë veprimtarinë zgjedhore, konstatohet se megjithëse ndalohet propozimi, miratimi ose nxjerrja e akteve ligjore ose nënligjore, të cilat parashikojnë dhënien e përfitimeve për kategori të caktuara të popullsisë, bëhet përjashtim kur nisma kushtëzohet nga gjendje të fatkeqësisë natyrore. Në rastin konkret e vërteta është që e gjithë situata e kallzuar lidhet në thelb me një fatkeqësi natyrore e konkretisht me tërmetin e rënë në territorin e Republikës së Shqipërisë, që përveç humbjes së jetës apo dëmtimit të shëndetit, solli edhe pasoja, dëme materiale në objekte të ndryshme, duke lënë të pastrehë apo duke dëmtuar godina të cilat në rast mosrregullimi mund të sjellin pasoja.

Ajo që konstatohet është se në fakt kemi të bëjmë me vendime procedurash, lidhur me fonde që janë dhënë me ligjin për buxhetin e vitit 2021. Konkretisht VKM-të e mësipërme rezultojnë të jenë mbështetur në, Aktin normativ nr. 9 datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore” miratuar me ligjin nr. 97/2019 në ligjin nr. 137/2020 “Për buxhetin e vitit 2021”.

Për më tepër, ka një diferencë mes veprës penale dhe asaj që mund të kualifikohet si shkelje administrative. Kodi Zgjedhor parashikon se burimet publike, nuk mund të përdoren ose të

**vihen në mbështetje të kandidatëve, të partive politike ose të koalicioneve në zgjedhje.** Kodi Penal parashikon se nuk mund të përdoren nga një punonjës që kryen një detyrë shtetërore, **i të mirave publike, funksionit ose veprimtarisë shtetërore, ose i burimeve financiare ose njerëzore** me qëllim favorizimin e një partie politike ose kandidati në zgjedhje. Në rastin konkret, përdorimi i të mirave, nuk rezulton të jetë bërë sipas logjikës që kanë këto dispozita. Përdorimi i të mirave apo funksioneve ka ndodhur sipas parashikimeve ligjore por gjithçka që diskutohet është koha kur ato janë përdorur. Kështu që arsytimi zbret tek ndalimi i Kodit Zgjedhor, që nuk duhet të miratohen akte të tilla në një periudhë që shkon deri në katër muaj para datës së zgjedhjeve. Në respektim të parashikimeve të Kodit Zgjedhor, në mungesë të ekzistencës së të dhënave në kuadrin penal, nxjerrja e akteve mund të arsyetohet nga organet përkatëse të ngarkuara me ligj, nëse përbëjnë apo jo kundërvajtje administrative.

Përsa më sipër, organi procedues vlerëson se nuk ka të dhëna të mjaftueshme që të mbështesin dyshimin se ekziston ndonje veper penale dhe për këtë arsye duhet të vendoset mosfillimi i procedimit penal.

Për sa më lart mbështetur në nenet 291 dhe 290/1 gërma “ç” të Kodit të Procedurës Penale,

#### VENDOSA

1. Mosfillimin e procedimit penal, për kallzimin penal me nr. 188 të vitit 2021.
2. Të njoftoj me këtë vendim kallzuesin.
3. Kundër këtij vendimi lejohet ankimi në Gjykatën e Shkalles së Parë Për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar brenda 10 ditëve nga njoftimi i vendimit.

**PROKURORE**  
**ENKELEDA MILLONAI**

